



## Informacion mbi sëmundjet që shkaktojnë rriqërat, drejtuar mësuesve dhe edukatorve ligjor

### Shkurt 2007

#### Njohuritë themelore

Rriqërat janë gjallesa të vogla që mezi shihen me sy, jetojnë nën lëkurën e drunjëve të pyllit, në periferitë e pyjeve dhe nëpër shkurre (gëmusha). Si ushqim atyre ju nevojitet gjaku i thithur nga kafshët e ndryshme por nganjëherë ata e ngatërrojnë veten edhe tek njerëzit. Në kundërshtim me insektet si: arëza (anëzat, grerëzat etj) dhe mushkonjat të cilat gjatë pickimit shkaktojnë dhimbje, pickimi nga rriqërat nuk shkakton dhimbje. Në shumicën e rasteve rriqërat vërehen trupin tonë pasi të jenë ngopur me gjak. Pas ngopjes me gjak rriqërat rriten edhe për disa milimetra me tepër. Ushqyeshmëria e tyre me gjak shpesh zgjat deri në disa ditë.

Për fat të keq rriqërat mund të shkaktojnë sëmundje të ndryshme. Tek ne deri me tani kryesisht janë të njohura dy lloje të këtyre sëmundjeve.

#### 1. Meningo-Enzefaliti i Hershëm Veror (FSME). – Ndezja e trurit nga rriqërat

Nëse përkthehen fjalët e mësipërme do të thotë truri përkatësisht ndezja e lëkurës së trurit. Pasiqë kjo sëmundje atakohet në verën e hershme atëherë edhe është emërtuar kështu.

Kjo sëmundje shkaktohet nga virusët, të cilët përmes pështymës së rriqërave vendosen tek organizmi i njeriut. Shenjat e sëmundjes janë: kokëdhembjet, pengesa nga drita, nuk përjashtohet edhe mundësia e paralizës. Mirëpo fatmirësisht paraliza dhe dëme të tjera në kundërshtim me të rriturit, tek fëmijët nuk qëndrojnë gjatë.

Jo të gjithë rriqërat janë bartës të kësaj sëmundje. Në Kantonin e Shafhauzenit të tillë janë vetëm 5% të rriqërave. Gjithashtu edhe kjo sëmundje takohet çdo herë e më rrallë. Raste të tilla në vitet e fundit janë lajmëruar nga një deri në 5 mbrenda vitit.

Fatmirësisht kundër kësaj sëmundje egziston mundësia e vaksinimit. Që vaksinimi të jetë i sukseshëm nevojiten tri seanca të vaksinimit: të dy vaksinat e para duhet të bëhen mbrenda një muajit dhe vakcina e tretë duhet të jipet pas një viti. Ripërsëritja e vaksinimit nuk është e nevojshme. Vaksinimi ju rekomandohet të gjithë personave që banojnë në një Kanton ku egziston rreziku nga sëmundjet (FSME) e shkaktuara nga rriqërat. Kjo ju takon edhe banorëve dhe banoreve të Kantonit të Shafhauzenit.

## **2. Borelioziti i Lymes (Die Lyme Borreliose.)**

Është sëmundje e shkaktuar nga bakterja e quajtur Borelijum (Borelium) dhe emërtuar sipas vendit ku është atakuar për herë të parë si sëmundje në Lym (Lyme) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kjo sëmundje fillon me një skuqje dhe të enjtur rrethore tek vendi ku ka pickuar rriqëri dhe shfaqet disa ditë pas pickimit. Në shumicën e rastëve në këtë kohë rriqëri nuk gjindet më aty. Kjo skuqje zbehet gradualisht pa ndërmarrë ndonjë masë mjekuese, mirëpo bakterjet mund të qëndrojnë në organizëm dhe vite më vonë shkaktojnë dhembje të nujeve dhe probleme tjera. Nëse vërehet një skuqje e tillë rrethore duhet të mjekohet me antibiotik që mos të ketë pasoja më vonë.

### **Masat e mundshme kundër sëmundjeve që shkaktojnë rriqërat**

#### **1. Shmangia nga pickimi i rriqërave**

Veshja e rrobave të gjata. Mirëpo kjo masë nuk është dhe aq e përshtatshme sidomos për fëmijë gjatë kohës së nxehtë, gjatë pranverës dhe verës. Pylli dhe zonat afër pyjeve duhet të të përdorën edhe me tutje si vendçlodhjeje.

#### **2. Shkurtimi i kohës së thithjes së gjakut nga rriqërat**

Menjëherë pas qëndrimit në pyll, trupi duhet të kontrollohet se mos ka rriqëra. Rriqërat kryesisht ngjiten: në: thyerjet e bërrylave, në nënsqetulla, në rrëzë të kofshëve, dhe rreth flokëve. Bartja e sëmundjes varet nga kohëzgjatja e thithjes gjak nga rriqërat. Tek koha e thithjes me pak se 8 orë sëmundja nuk do të bartet tek njeriu. Rriqërat mund të hiqen shumë lehtë me një pincetë. Tek rastet urgjente edhe pinceta e briskut të xhepit kryen punë.

#### **3. Vaksinimi kundër Meningo- Encefalitit të Hershëm Veror.**

Vaksinimi rekomandohet nga Komisioni Zviceran i Vaksinimit për të gjithë banorët e Kantonit nga mosha 6 vjeçare. Vaksinat injektohen nga mjeku i shtëpisë dhe do të paguhen nga Sigurimi Shëndetësor (Krankenkassa).

### **Përmbledhje:**

- Rriqërat mund të jenë bartës të sëmundjeve. Këto sëmundje janë të rralla. Masa më e rëndësishme pas qëndrimit në pyll është kontrollimi i trupit dhe largimi sa më i shpejtë i rriqërave nga trupi. Kundër sëmundjes së ndezjes së trurit (FSME) të shkaktuar nga rriqërat rekomandohet vaksinimi.
- Pavarësisht kësaj pylli dhe zonat rreth tij duhet të frekuentohen nga shkollat edhe me tutje .

Dr. J. Häggi

Kantonsarzt des Kantons Schaffhausen